



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1050_10_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 18.11.2013

në seancën e mbajtur më datë 20 dhjetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin N. L, (shifra e konsumatorit DGL - 85005) nga Gjilani ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1050_10_13 i datës 24.10.2013.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 01.03.2011 kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 174890 me gjendje: TL=23627 kW (tarifa e lartë) dhe TU=19456 kW (tarifa e ulët) dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 47446152 me gjendje: TL=0 kW (tarifa e lartë) dhe TU=0 kW (tarifa e ulët).

Pas kësaj punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 08.03.2011 kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 174890 me gjendje: TL=23627 kW (tarifa e lartë) dhe TU=19456 kW (tarifa e ulët) dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 47446152 me gjendje: TL=0 kW (tarifa e lartë) dhe TU=0 kW (tarifa e ulët).

Punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit me datë 21.04.2011 kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 174890, ku është konstatuar se njehsori elektrik dy bllomba shtetërore i ka të falsifikuara kurse një i mungon, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, në brendi të njehsorit sistemi i fazës "R" është i eliminuar dhe se si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike për 33.33% më pak.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 28.06.2011 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DGL11HP02625 në vlerë prej 695.30€. Pas kësaj fature konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.



Departamenti për Konsumator në KEK me datë 19.07.2011 konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike është bazuar sipas procesverbalit të kalibrimit nr. 4925 i datës 26.04.2011.

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 24.10.2013 ka nxjerr vendim duke e refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: 1) të shkarkoj konsumatorin nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike DGL11HP02625 (rikthimi i humbjeve) i datës 28.06.2011 në vlerë prej 695.30€; dhe 2) të bëjë rilogaritjen e faturës së paautorizuar të energjisë elektrik (rikthimit të humbjeve) duke marr për bazë shpenzimin e krijuar dhe të regjistruar muaj për muaj nga konsumatori në njehsorin elektrik nr. 174890 dhe të njëjtës t'i shtohet nga 1/3 (një e treta e energjisë) për muaj, në kohëzgjatje prej 6 muaj ashtu siç është llogaritur në shfrytëzimit të paautorizuar.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 18.11.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se sipas sektorit të kalibrimit njehsori padyshim që është i keqpërdorur ku dy blloba i ka të falsifikuara si dhe një bllobë i mungon, si dhe në brendi sistemi i fazës "R" është i eliminuar dhe se si pasojë njehsori ka regjistruar energji elektrike për 33.3% më pak. Mbi këtë bazë është llogaritur edhe vlera e rikthimit të humbjeve duke i zbritur energjinë elektrike të faturuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 174890, ku është konstatuar se njehsori elektrik dy blloba shtetërore i ka të falsifikuara ndërsa një vulë (bllobë) i mungon, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, në brendi të njehsorit sistemi i fazës "R" është i eliminuar dhe se si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike për 33.33% më pak. Sipas kësaj është dashur që të merret për bazë llogaritja e shpenzimit të regjistruar në njehsorin elektrik për muaj dhe mbi këtë bazë të shtohet edhe 1/3 (një e treta) e shpenzimit të energjisë për çdo muaj dhe të llogaritet e njëjta për periudhën siç është përcaktuar në faturën e rikthimit të humbjeve për 6 muaj.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë dokumenteve të lëndës përkatësisht shpenzimit të energjisë elektrike ka vërejtur se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr. 174890 prej periudhës 08/2002 e deri më 02/2011 është 372 kWh/muaj ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin elektrik nr. 47446152 prej periudhës 03/2011 e deri më 09/2013 është 466 kWh/muaj. Pra shpenzimi i energjisë elektrike me njehsorin e ri nr. 47446152 është rritur për 25 % më shumë se sa shpenzimi i regjistruar me njehsorin e vjetër nr. 174890. Gjatë analizës së faturës së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike (fatura e rikthimit të humbjeve) ka vërejtur se KEK-u gjatë kalkulimit ka gabuar në llogaritjen e energjisë mesatare të faturuar ku vërehet se KEK-u në faturën nr. 1233 të datës 28.06.2011 ka theksuar se energjia mesatare e faturuar është 232 kWh/muaj, ndërsa sipas llogaritjeve të bëra nga DMK vërehet se mesatarja e energjisë elektrike të faturuar është 450.17 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe listat e leximit nga periudha 02/2010, 11/2010, 01/2011 dhe 03/2011, dhe se sipas kësaj përveç gjendjes së evidentuar të shpenzimit, lexuesi ka evidentuar edhe gjendjen e vulës distributive dhe se sipas kësaj në të gjitha listat vula distributive ka qenë n rregull, përveç listës së periudhës 02/2010 në të cilën lexuesi nuk ka evidentuar asgjë te vula distributive.



Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1050_10_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar